

Në bazë të nenit 55 paragrafit 1 të Ligjit për organizimin dhe punë në organet e administratës shtetërore („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 , 51/11 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 96/19 dhe 110/19), si dhe në bazë të nenit 50 paragrafit 6 nga Ligji për arsim fillor (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 161/2019) ministri i Arsimit dhe Shkencës e përcaktoi programin e shkurtuar mësimor për lëndën mësimore **Etika për klasën VII (shtatë)** të arsimit fillor nëntëvjeçar për vitin shkollor 2020/2021.

1. HYRJE

Programi mësimor i shkurtuar, i lëndës **Etika për klasën e VII (shtatë)** të arsimit fillor nëntëvjeçar për vitin shkollor 2020/21, bazohet në qëllimet e parashikuara në programin mësimor për lëndën mësimore që zbatohet rregullisht sipas planit mësimor të përcaktuar.

Me programin e shkurtuar përcaktohen tema dhe njësi mësimore që duhet të realizohen në 159 ditë mësimore, gjatë së cilës konsiderohet fondi i paraparë javor i orëve të përcaktuar në programin e rregullt, respektivisht për një lëndë mësimore me fond javor prej 1 ore, parashikohen 32 orë në programin e shkurtuar mësimor.

Mësuesi gjatë planifikimit dhe realizimit të njësive mësimore nga programi i shkurtuar, drejtohet kah qëllimet, nocionet e përcaktuara, metodat dhe aktivitetet e përcaktuara në programin e rregullt mësimor.

2. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I TEMAVE DHE NJËSIVE MËSIMORE

Tema 1: **ETIKA DHE MORALI** (10 orë)

Njësitë mësimore:

- Çfarë është etika?
- Morali
- Rëndësia e moralit
- Shën Klimenti i Ohrit

Tema 2: VLERAT ETIKE UNIVERSALE (12 orë)

Njësitë mësimore:

- Etika në tërë botën
- Ndershmëria
- E vërteta
- Drejtësia
- Etika universale
- Etika e shëndetit, ekologjisë dhe informatikës

Tema 3: SJELLJA E MIRË (10 orë)

Njësitë mësimore:

- Sjellje e mirë
- Sjellja në familje
- Sjellja në shkollë
- Sjellja midis shokëve
- Sjellja e mirë ne publik
- Sjellje e mirë ndaj njerëzve të tjerë

3. REKOMANDIME DIDAKTIKE

Pika fillestare për realizimin e programit të shkurtuar mësimor nga lënda mësimore **Etika** është programi i rregullt mësimor (qëllimet konkrete, nocionet, aktivitetet dhe metodat e rekomanduara). Është i nevojshëm një planifikim i integruar, respektivisht lidhshmëria e qëllimit dhe përmbajtjes, si dhe planifikimi i mësimdhënies duke lidhur mësimin me përvojën e nxënësve. Për realizimin e lëndës mësimore Etika, patjetër të zbatohen forma dhe metoda interaktive (teknika të të mësuarit dhe aktivitete). Nga metodat interaktive do të përdoren: puna në grup, diskutime, debate, stuhi idesh, si dhe metoda tradicionale: leksione të shkurtra, biseda të përqëndruara. Rekomandimet për përdorimin e fondit të shkurtuar të orëve jepen si orientim, së bashku me qëllimet konkrete dhe temat/përmbajtjet që nuk duhet të kufizojnë rivendosjen e tyre sipas nevojave gjatë realizimit.

Kontrollimi i njohurive të nxënësve duhet të bëhet në të gjitha fazat e procesit mësimor, gjatë realizimit të përmbajtjes së re, përsëritjes, kontrollit, sistemimit, ushtrimit dhe hulumtimit.

Gjatë vëzhgimit dhe vlerësimit zbatohen procedura të ndryshme (përgjigjet me gojë dhe me shkrim, teste të njohurisë, aktivitetet e nxënësit gjatë orës).

Mjetet e mësimi:

- Libri shkollor i zgjedhur në nivel të shkollës për lëndën përkatëse, i miratuar na Ministri;
- Fjalori etik, tekste etike, revista, botime speciale etj.
- Internet, software të famshëm arsimor të ilustruar;
- Mjete audio-vizuele dhe mjete të tjera të përshtatshme për lëndën.

4. **NORMATIVI PËR KUADRIN MËSIMOR**

Programin e shkurtuar mësimor e realizon mësimdhënës në përputhje me normativin për kuadër mësimor të dhënë në programin e rregullt mësimor.

Programin e shkurtuar mësimor për lëndën **Etika për klasën e VII (shtatë)** të arsimit fillor e miratoi

Ministri i Arsimit dhe Shkencës

Milla Carovska